REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS TURIZMIT DHE SPORTIT

Nr. 3052 **Prot.** **Datë** 23/09/**2025**

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT TË FËMIJËVE PËR HERË TË PARË NË KOPËSHT"

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Devoll!

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar Urdhërin nr. 420, datë 27.8.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020,"Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, po ju paraqesim relacionin mbi projekt-vendimin si më poshtë:

Në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e arsimit parauniversitar, Bashkia Devoll ka propozuar miratimin e procedurave dhe kritereve për regjistrimin e fëmijëve në institucionet e arsimit parashkollor. Kjo është një iniciativë e domosdoshme për të siguruar një sistem të rregullt, të drejtë dhe të organizuar për regjistrimin e fëmijëve, duke i mundësuar atyre qasjen në arsimimin e hershëm dhe të nevojshëm për zhvillimin e tyre.

Ky projekt-vendim është në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të tjera që rregullojnë arsimin në Shqipëri. Ai gjithashtu mbështetet në ndryshimet e fundit që janë bërë në aktet rregullatore, duke siguruar kështu që procedurat të jenë të përditësuara dhe të përshtatura me kërkesat ligjore.

Në Urdhërin nr. 420, datë 27.8.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020,"Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar janë bërë ndrshimet si më poshtë:

Neni 5 , pika 6 e kreut II "Organizimi I institucioneve të arsimit parashkollor "Regjistrimi i fëmijës në institucionet e arsimit parashkollor bëhet nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore sipas procedurave të përcaktuara nga NJVV-ja përkatëse"

Në zbatim të këtij urdhëri kërkojmë Miratimin e procedurave të regjistrimit të fëmijëve për herë të parë në kopësht do të jenë si më poshtë:

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS TURIZMIT DHE SPORTIT

PROJEKT-VENDIM

NR 56 DATE 23 / 09 /2025

"PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT TE FËMIJËVE PËR HERË TË PARË NË KOPËSHT"

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar Urdhërin nr. 420, datë 27.8.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020,"Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e procedurave të regjistrimit të fëmijëve për herë të parë në kopësht.
2. Dokumentat e regjistrimit të fëmijëve për herë të parë në kopësht:
   a) Certifikatë lindje e fëmijës
   b) Vërtetim i vaksinimit të fëmijës
   c) Formulari Tip shtojca nr.1 me logon e Bashkisë Devoll
   ç) Analizë mjekësore
3. Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Sportit.
4. Ky vendim do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015 data 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Konceptoi: Drejtor i Drejtorisë të Arsimit Kulturës Turizmit dhe Sportit

Eliverta Pavliqoti

Konfirmoi bazën ligjore: Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

Dokumentat e regjistrimit të fëmijëve për herë të parë në kopësht:

a) Certifikatë lindje e fëmijës

b) Vërtetim i vaksinimit të fëmijës

c) Formulari Tip shtokca nr.1 me logon e Bashkisë Devoll

ç) Analizë mjekësore fece parazit (Brenda muajit Shtator)

Konceptoi: Drejtor i Drejtorisë të Arsimit Kulturës Turizmit dhe Sportit

Eliverta Pavliqoti

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288
bashkiadevoll@gmail.com